

Nr. 2305/43 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 11/05/2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: **DENONCIM Nr. 10** – Lidhur me
organizimin e koncerteve
përgjatë ose në lidhje me tubimet
elektorale nga Koalicioni Bashkë
Fitojmë dhe Partia Socialiste.

I Nderuar Z. Komisioner!

Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Kodi Zgjedhor në nenin 78 “Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës”, në pikën 9 të tij përcakton se “*Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqje kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate ose jashtë saj.*”

Nga monitorimi i bërë ka rezultura që subjektet zgjedhore kanë organizuar veprimtari të cilat hyjnë në sferën e parashikimeve të këtij neni, por KRIIK po ju përcjell denoncimin e tij vetëm për dy prej tyre, të organizuara përkatësisht nga subjektet zgjedhore Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Konkretisht:

Denoncimi 10.1. Organizimi i koncertit të Kandidatit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për Kryetar të Bashkisë Tiranë, z. Belind Këlliçi.

Në pamjet foto dhe video të postimeve të paraqitura në vijim të këtij denoncimi evidentohet qartë thirrja dhe organizimi i veprimtarisë “koncert” si dhe prezenca e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” dhe Kandidatit të tij për Kryetar të Bashkisë Tiranë për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023.

Konkludohet se kemi të bëjmë me një tubim elektorale, i cili i ka të gjitha elementët përbërës të tij si fjalime, thirrje, pankarta, slogane, logo, si dhe zhvillimi në të njëjtën kohë i një koncerti me këngëtarë të ftuar, të cilët performojnë, këndojnë dhe shfaqen në mbështetje të këtij subjekti zgjedhor.

Address:


Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në datën 05.05.2023 në faqen Facebook të një prej aktivistëve të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” është postuar video e zhvillimit të një koncerti të kandidatit të këtij koalicioni për Kryetar të Bashkisë Tiranë, z. Belind Këlliçi.

Konkretisht linku i postimit të videos së koncertit është: <https://www.facebook.com/grigelsmuçollariofficial/videos/758414942643517/>, ndërsa foto/printscreens e tij:



Përmbajtja e statusit të shkruar që shoqëron këtë postim është:

"#LIVE - Koncert i organizuar nga FRPD me pjesëmarrjen e Renis Gjoka, Eugent Bushpepa, Vin Veli dhe Aleksandër Gjoka"


Lidhur me këtë aktivitet ka patur edhe [një njoftim paraprak](#), ku evidentohet organizatori i koncertit që është FRPD. Më poshtë teksti i postimit dhe foto/printscreens i tij:

"Renis Gjoka, Eugent Bushpepa, Aleksandër Gjoka dhe Vin Veli ju presin tek Fusha e Aviacionit #Njësia7.

Nisuni 🇹🇷 🇹🇷 🇹🇷

Time to Rock the Dictator!

[#BelindKëlliçi](#) [#Tirana](#) [#FRPD](#) [#BashkëFitojmë](#)"




Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe subjekti zgjedhor, [kandidat i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”](#) për Kryetar në Bashkinë Tiranë, z. Belind Këllici. Më poshtë teksti i postimit dhe foto/printscreens i tij:

*“Na dhanë kaq shumë energji të rinjtë e FRPD mbrëmë me koncertin e organizuar prej tyre. Jeni më të mirët, Bashkë Fitojmë! 🍷
[#BelindKellici5](#) [#BashkeFitojme1](#) [#Belo5](#)”*



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
 Nd.4, H.2, Ap.3,
 Nj.Adm.5,
 Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
 Tirana, 1001,
 Albania

Denoncimi 10.2. Organizimi i koncertit të Kandidatit të Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetar të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj

Në pamjet foto dhe video të postimeve të paraqitura në vijim të këtij denoncimi evidentohet qartë thirrja dhe organizimi i veprimtarisë “koncert” si dhe prezenca e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste

e Shqipërisë” dhe Kandidatit të tij për Kryetar të Bashkisë Tiranë për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023.

Konkludohet se kemi të bëjmë me një tubim elektorale, i cili i ka të gjitha elementët përbërës të tij si fjalime, thirrje, pankarta, slogane, logo, si dhe zhvillimi në të njëjtën kohë i një koncerti me këngëtarë të ftuar, të cilët performojnë, këndojnë dhe shfaqen në mbështetje të këtij subjekti zgjedhor.

Theksohet se prezent në këtë koncert e tubim elektorale ka edhe këngëtarë të tjerë, përveç këngëtarit që këndon himnin elektorale të fushatës së PS, i cili është i pranishëm dhe performon pothuajse në të gjitha tubimet elektorale që organizon ky subjekt zgjedhor.

Në datën 09.05.2023 në faqen zyrtare [Facebook të Kryetarit të Bashkisë Tiranë](#) dhe njëkohësisht Kandidatit të Partisë Socialiste për Kryetar të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliq, është postuar video e zhvillimit të një tubimi elektorale, pjesë përbërëse e të cilit është edhe një koncert i zhvilluar. Më poshtë teksti i postimit dhe foto/printscreens i tij:

“Me Fridën dhe banorët e Petrelës, Baldushkut dhe Farkës 🇹🇷, dy njësi që janë transformuar falë punës dhe vendimit për të ecur përpara me Partinë Socialiste 🇹🇷.”

Me Fridën dhe banorët e Petrelës, Baldushkut dhe Farkës 🇹🇷, tre njësi që janë transformuar falë punës dhe vendimit për të ecur përpara me Partinë Socialiste 🇹🇷.”



[Një postim në faqen e saj zyrtare](#) në facebook lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Ministri e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural znj. Frida Krifca. Më poshtë teksti i postimit dhe foto/printscreens i tij:

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

*“Magjike atmosfera mes njerëzve të Petrelës, Farkës e Baldushkut.
Një forcë e jashtëzakonshme na bashkon drejt një vizioni të qartë
zhvillimi për të ecur vetëm [#përpara](#).*

[#VetëmPërpara](#) 🇹🇷
[#KurrëMëMbrapa](#) 🇹🇷
[#KrenarepërPS](#) 🇹🇷🇹🇷”



Ky tubim është transmetuar edhe nga disa media-audiovizive:

1. Top Channel/ Veliaj në takimin e madh të Petrelës, Farkës dhe Baldushkut <https://top-channel.tv/video/top-neës-veliaj-ne-farke-petrele-e-baldushk-investimet-e-bashkise-dyfishuan-vleren-e-prones/> ;
2. TV Klan Veliaj takime në Petrelë, Farkë e Baldushk <https://tvklan.al/veliaj-takime-ne-petrele-farke-e-baldushk/> ;
3. Top News - Veliaj në Farkë, Petrelë e Baldushk / 'Investimet e bashkisë dyfishuan vlerën e pronës' <https://www.youtube.com/ëatch?v=oJb6AIus-Ys> .

Referuar sa më sipër, ju përcjellim këto dy denoncime për tu marrë në shqyrtim prej KQZ-së e kryer hapat e parashikuar proceduriale lidhur me këtë shkelje të Kodit Zgjedhor, për të cilët **nevojitet të sanksionohen të dy subjektet zgjedhorë, subjekti i partisë politike përkatëse si dhe subjekti kandidat për kryetar bashkie.**

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania